



SYLLABUS I LËNDËS: “ROMANI SHQIPTAR”

Të dhëna bazike të lëndës:	
Universiteti:	Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Romani shqiptar
Programi:	Gjuhë dhe letërsi shqipe
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore (Z)
Viti i studimeve:	Viti IV, Semestri VII
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	Semestri dimëror
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. ass. dr. Manjola Brahaj Halili
Të dhënat kontaktuese:	manjola.brahaj@uni-prizren.com
Përshkrimi i lëndës:	<p>Programi i lëndës “Romani shqiptar” synon të prezantojë trashëgiminë tonë letrare të romanit si zhanër letrar, duke nisur që nga filltet e tij e deri në ditët e sotme.</p> <p>Me këtë paraqitje historike të lindjes, zhvillimit dhe konsolidimit të romanit shqiptar si gjini synohet që të nxirren në pah edhe kushtet letraro – historike që kanë ndikuar në zhvillimin dhe pasurimin e saj me kalimin e kohës. Për ta bërë të mundur më së miri kuptimin dhe avancimin e romanit shqiptar nëpër periudha të ndryshme historike, por edhe për të nxjerrë tipare origjinale dhe dalluese të tij, do të ndalemi tek figurat me të rëndë- sishme, deri tek romancierët bashkëkohorë.</p>
Qëllimi i lëndës:	<p>Qëllimi i këtij kursi është që studentët të përvetësojnë e zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për lindjen, zhvillimin dhe konsolidimin e romanit shqiptar. Të njohin kushtet historike nëpër të cilat ka kaluar ky zhanër dhe prej të cilave është kushtëzuar zhvillimi i tij. Gjithashtu kjo lëndë ka për qëllim që të njohë studentët me individualitetet më të rëndësishme të romanit, me llojet e romanit, me tiparet dhe veçoritë specifike që i dallojnë ata nga njëri – tjetri.</p>
Rezultatet e të nxënit:	<p>Gjatë dhe pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none">• njohin autorët dhe vlerat kryesore të romanit shqiptar;• dallojnë veçantitë kryesore të individualiteteve të shquara të romanit shqiptar;• përshkruajnë kushtet nëpër të cilat kaloi zhvillimi i romanit shqiptar;• interpretojnë idetë, pikëpamjet, vlerat dhe rëndësinë gjuhësore, historike estetike dhe artistike të romanit shqiptar;



	<ul style="list-style-type: none"> vlerësojnë vendin që zë romani shqiptar në kuadër të letërsisë shqipe dhe rolin që ka ai në prezantimin e letërsisë shqipe në botë. 		
Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Kollokfiime, seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	10	10
Përgatitja përfundimtare për provim	1	13	13
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	1	5	5
Totali			100 orë (4 ECTS)
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjëratat do të organizohen në modelin interaktiv ose të kombinuar si: shpjegim - sqarim, ushtrime, analiza tekstuale dhe shkencore, diskutime, punë në grupe, demonstrime dhe interpretime, prezantime dhe rishikime ide, dizajne kreative dhe vetë-kërkuese, etj. pjesa kryesore për punën vlerësuese dhe mënyrën apo metodologjinë e pedagogut.		
Metodologjia e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i studentëve bazohet në punën, aktivizimin, frekuentimin, kolekviumet dhe punimin e prezantuar në përmbyllje të semestrit.</p> <ol style="list-style-type: none"> Testi i parë: 1-35 % Testi i dytë: 1-35 % Prezantimet studentore 1– 10 %, Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 1-20 % Totali: 100 % <p>(Vlerësimi në pikë: 01-50= 5, 51-60 = 6, 61-70 = 7, 71-80 = 8, 81-90 = 9, 91-100=10</p>		
Literatura			

Literatura primare:	<p>Hasan Mekuli: Romani shqiptar: kritika dhe vështrime, “Libri shkollor”, Prishtinë, 2000.</p> <p>Sefedin Fetiu: Poetika e romanit shqiptar (1952 – 1977), Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1992.</p> <p>Bajram Krasniqi: Poetika e romanit historik, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1985.</p>
Literatura shtesë:	<p>Manjola Brahaj Halili: Proza eksperimentale – rasti i Pashkut, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 2019.</p> <p>Grup autorësh: Historia e letërsisë shqiptare, “Rilindja”, Prishtinë, 1989.</p> <p>Robert Elsie: Historia e letërsisë shqiptare, “Dukagjini”, Pejë, 2011.</p> <p>Gjergj Llukaç: Teoria e romanit, “Rilindja”, Prishtinë, 1983.</p> <p>Çështje të romanit: Rilindja, Prishtinë 1980.</p>

Plani i dizajnuar i mësimi:		
Java	Ligjërata	Ushtrime
<i>Java e parë:</i>	Zanafilla e zhanrit të romanit. Vështrim i përgjithshëm mbi origjinën e romanit botëror dhe atij shqiptar.	<i>Diskutime rreth origjinës dhe kushteve të krijimit të romanit shqiptar</i>
<i>Java e dytë:</i>	Romancierët e parë. Ndoc Nikaj - Lloji i romanit “Shkodra e rrethueme”(1967), veçoritë dhe tiparet strukturore – tematike. Pashko Vasa – “Bardha e Temalit” (1969). Risitë dhe mangësitë .Foqion Postoli - “Për mbrojtjen e atdheut” – romani patriotik dhe veçoritë e tij.	<i>Diskutime për romanet: “Shkodra e rrethueme” dhe “Bardha e Temalit”</i>
<i>Java e tretë:</i>	Haki Stërmilli – romancieri sentimentalist. “Sikur të isha djalë”, ndërtimi, rrëfimi, risitë dhe aspekte të tjera.	<i>Analizë e tipareve sentimentaliste të romanit “Sikur të isha djalë”</i>
<i>Java e katërt:</i>	Romancierët social dhe realist. Stërjo Spase – romancieri social. “Pse”, “Ata nuk ishin vetëm” dhe “Afërdita”, tematikat dhe veçoritë dalluese. Jakov Xoxa – “Lumi i vdekur”, tiparet dhe rëndësia e tij letrare.	<i>Diskutim për tiparet dhe veçoritë e romanit social dhe atij realist. Bazuar tek romanet “Pse” dhe “Lumi i vdekur”</i>

Java e pestë:	Romancierët socrealistë . Fatmir Gjata – ”Këneta”, tematika, trajtimi dhe vlerat estetike.	Analizë e ndërtimit dhe tematikës së romanit socrealist ”Këneta”
Java e gjashtë:	Petro Marko – romancieri i “brezit të humbur”. “Qyteti i fundit” – dashuria dhe lufta, ballafaqimi i të kundërtave. ”Intervistë me vetveten” – romani autobiografik, rrëfimi, struktura, risitë dhe vlerat letrare e historike të veprës.	Diskutime për letërsinë e brezit të humbur; konkretizime të temave, tipareve strukturore dhe rrëfimit në romanet e Petro Markos.
Java e shtatë:	Anton Pashku – romancieri i parë eksperimental. ”Oh” – modernizmi dhe eksperimenti me gjuhën, strukturën dhe rrëfimin.	Analizë dhe diskutime rreth eksperimentalitetit të romanit të Pashkut.
Java e tetë:	Testi i parë vlerësues	Përmbledhje dhe diskutime
Java e nëntë:	Ismail Kadare – Vlera dhe rëndësia kombëtare e ndërkombëtare e romaneve të tij.	Analizë e veprës “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”
Java e dhjetë:	Kasem Trebeshina shkrimtari disident – ”Kënga shqiptare”, romani i parë eupope.	Analizë dhe lexime fragmentesh nga romani i parë eupope.
Java e njëmbëdhjetë:	Martin Camaj – romancieri alegorik. “Rrathë” dhe “Shkundullima”, simbolika, narracioni dhe struktura.	Diskutime për simbolikën dhe ndërtimin e saj te romani “Rrathë”
Java e dymbëdhjetë:	Dritëro Agolli – romancieri satirik. ”Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, simbolika, tragjikomizmi, personazhet dhe konteksti social – politik.	Lexime fragmentesh dhe diskutime për ndërtimin e satirës te romani “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”
Java e trembëdhjetë:	Rexhep Qosja – romancieri vizionar. Vlera artististike,, kombëtare dhe estetike e romaneve të tij.	Analizë dhe diskutime rreth simbolikës vizionare tek romani ”Vdekja më vjen prej syve të tillë”
Java e katërbëdhjetë:	Romancierët postmodernist. Agron Tufa – Risitë rrëfimore, estetike, tematike dhe gjuhë sore. Veçoritë e stilit dhe rëndësia letrare e romaneve të tij. Ridvan Dibra – posmodernizmi, origjinaliteti dhe vlerat letrare të krijimtarisë.	Realizimi i postmodernizmit, vlerat dhe modelet, duke u bazuar tek romanet; ”Dueli” dhe ”Triumfi i Gjergj Elez Alisë”
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi i dytë vlerësues	Diskutime dhe konsultime rreth rezultateve të arritura



Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Nuk do të ketë kurrfarë tolerime për “huazim” nga interneti apo kudo tjetër. Punimet e njejta apo të ngjajshme gjithashtu do të ndëshkohen. Rekomandohet që punimet që dorëzohen të jenë të shkruara me kompjuter.

- Studentët duhet t’u përbahen rregullave të përcaktuara sipas Statutit të UPZ-së dhe rregulloreve dhe vendimeve të miratuara nga Senati i UPZ-së dhe këshilli mësimor.
- Pritet që secili student të vijë me kohë.
- Nga çdo student pritet që të marrë pjesë në çdo ligjeratë.
- Për shkak të natyrës dhe mënyrës së mësimit në këtë lëndë, ardhja në mësim dhe pjesëmarrja aktive në diskutim është me rëndësi të veçantë.